



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 78

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Prishtinë, më 9 shtator 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Bahri Thaçi, Liburn Aliu dhe Salihe Mustafa.

Munguan: Sasha Gjokiq, Gëzim Kelmendi dhe Nazane Breca .

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Xheneta Sopjani, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 24 .07.2013 dhe 30.07.2013**
- 3. Azhurnimi i planit të punës së Komisionit**
- 4. Të ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës;
Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 24 .07.2013 dhe 30.07.2013

Procesverbalet nga mbledhjet e datës 24.07.2013 dhe 30.07.2013 u miratuan pa vërejtje .

3. Azhurnimi i planit të punës së Komisionit

Fikrim Damka, tha se sekretaria ka përgatitur një draft të planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor. Në këtë draft janë përfshirë të gjitha Projektligjet që i kemi në procedurë të shqyrtimit dhe Projektligjet që pritet të procedohet nga Qeveria e që me plotësimin dhe ndryshimin e strategjisë legislative që ka ardhur nga Qeveria nuk ka ndonjë ndryshim.

Fillimisht te përfundojmë punën në projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Time Kadrijaj –Tha se duhet të punojmë edhe për Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre

Liburn Aliu – Tha se i përket për Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre , jemi në përfundim të punës kemi vetëm të realizojmë një takim me zyrën e kryeministrit dhe me shoqatat e luftës dhe do ta përfundojmë.

Flora Brovina –Tha se duhet te mbajmë edhe një takim për Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe nëse ka nevojë prapë do të bëjmë ndryshime .

Pas diskutimeve Komisioni miratoj planin e punës për sesionin vjeshtor.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka